



Datë: 19.05.2025

Numër Protokolli: 3543/2025

A.nr.488/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.488/2025, të datës 18.03.2025, të parashtruar nga ankuesja L.D., kundër organit të punësimit: Komuna e Klinës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.488/2025, e datës 18.03.2025, e parashtruar nga ankuesja L.D., ndërsa, **detyrohet** Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Klinës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr veprimet për klasifikimin e vendeve të punës për ankuesen, në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Klinës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën **I** të dispozitivit.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, L.D.(*në tekstin e mëtejme: referuar ankuesja*), më datë 18.03.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos ndryshimin e koeficientit të pagës nga klasa profesionale 3 në klasën profesionale 2 sipas Katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna

e Klinës, ndërsa, kjo e fundit më datë 18.04.2025 ka përcjellë përgjigje në ankesë së bashku me dokument e kërkuara nga Këshilli.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1770/2025 të datës 18.03.2025 të parashtruar nga ankuesja përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 15.03.2025; Kërkesën e datës 13.03.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Vendimin me numër Nr.08/226 të datës 23.10.2024; Klasifikimin e vendeve të punës nga Komuna e Klinës; Konkursin me numër reference RN00015978; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë drejtuar Komunës së Klinës; Përgjigjen në ankesë të dorëzuar nga organi i punësimit të datës 17.04.2025 së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Diplomën me numër Nr.786 të datës 02.04.2019; Akt emërimit me numër protokolli 02Nr.112-29757/2024 të datës 02.09.2024; Kërkesën me numër protokolli 14.03.2025; Kërkesën e datës 25.03.2025; Përkshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar për Gjendje Civile;; Katalogun e vendeve të punës në Komunën e Klinës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se rastin e ankuses, është e bazuar, **sepse:**

Nga provat e administruara të lëndës rezulton se ankuesja është e punësuar në Komunën e Klinës dhe se e njëjta sipas Akt emërimit me numër protokolli 02 Nr.112-29757/2024 të datës 02.09.2024 mbanë pozitën e punës Zyrtare për Gjendje Civile në Drejtorinë e Administratës, në kategorinë profesionale, klasa Profesional 3 me klasë dhe koeficient të pagës GJ45 (3.92).

Më tej sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesja më datë 13.03.2025, përmes postës elektronike ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës që të zbatohet katalogu i ri i vendeve të punës për shërbimin civil që pozita e saj të kaloj nga klasa profesional 3 në klasën profesional 2, ndërsa kjo e fundit përmes Zyrtarit të Lartë të Personelit më datë 14.03.2025 përmes postës elektronike ka njoftuar ankuesen se Komuna ka miratuar buxhetin për vitin fiskal 2025 dhe është planifikuar për pozitat e tilla koeficienti e pagës (3.92), dhe për rrjedhojë pas miratimit të katalogut të vendeve të punës i jemi drejtuar Zyrtarit Kryesor Financiar me kërkesë për të kërkuar konfirmimin për mjete buxhetore dhe meqenëse nuk kemi marr përgjigje nuk mund të veprojmë me ndërrimin e akt emërimeve, duke e udhëzuar që mund të parashtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Katalogu i Vendeve të Punës në shërbimin civil parasheh pozitën e saj si kategori profesionale klasa profesional 2, nuk është zbatuar nga organi punëdhënës, duke theksuar tutje se pas miratimit të buxhetit është shpall konkursi për një pozitë të tillë në kategorinë profesionale 2. Kërkon që ankesa të aprovohet, duke e obliguar komunën e Klinës që të bëjë plotësimin e akt emërimit nga klasa profesional 3 në klasën profesional 2 si dhe e njëjta kërkon ekzekutimin e pagës sipas koeficientit të

ekuivalencës së klasës së pagës për kategorinë e nivelit profesional 2, në mënyrë retroaktive nga dita e hyrjes në fuqi të katalogut të vendeve të punës.

Kolegji i Këshillit, në shqyrtim të pretendimeve ankimore të ankueses, dhe bazuar në shkresat e bashkangjitura të lëndës nga palët në procedurë, rezulton fakti se pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, sipas Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve, Komuna e Klinës pozitën e ankueses e ka propozuar në kuadër të klasës profesionale 2, mirëpo më datë 06.10.2023, sipas përcaktimeve përkatëse nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, kjo pozitë ishte caktuar në klasën e ekuivalencës 3.92 (profesional 3), ashtu që Komuna e Klinës pasi që ka përfunduar procesin e ristrukturimit, ankueses i ka lëshuar Akt Emërimit 02Nr.112-29757/2024, të datës 02.09.2024, për pozitën e njëjtë në kategorinë profesionale, klasa profesional 3, me klasë dhe koeficient GJ45, 3.92.

Qeveria e Republikë së Kosovës, sipas Vendimit me Nr. 08/226 të datës 23.10.2024, ka miratuar Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, ku në pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar: Obligohen të gjitha institucionet që të përfundojnë klasifikimin e vendeve të punës në përputhje me Rregulloren Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe këtë katalog. Rrjedhimisht sipas Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil të miratuar sipas vendimit të cekur si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas numrit rendor 1118 është paraparë pozita Zyrtar i Gjendjes Civile me kodin SHC-1118, Klasa Profesional 2 Grupi i Shkencave Shoqërore.

Duke marr parasysh faktin se me miratimin e Katalogut të vendeve të punës për shërbimin civil, kemi rrethana të reja juridike sa i përket klasës në të cilën janë kategorizuar pozitat Zyrtar i Gjendjes Civile, me qëllim të klasifikimit të vendeve të punës, Kolegji për vendosjen e kësaj çështje juridike, ju referuar edhe dispozitave të Rregullos (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, respektivisht:

- **Nenit 22**, ku përcaktohet: 1. Çdo vend pune në shërbimin civil, është pjesë e një prej klasave në shërbimin civil të përcaktuara sipas kësaj Rregullore. 2. Çdo pozitë konkrete e kategorisë profesionale, klasifikohet si pjesë e një prej tri (3) klasave të kategorisë përkatëse. 3. Klasifikimi i një pozite në kategorinë e profesionale apo të specialistëve bëhet në bazë të procesit të vlerësimit dhe klasifikimit të punës në pajtim me nenet 21-26 kësaj Rregulloreje.

- **Nenit 23**, ku përcaktohet: 1. Klasifikimi i një vendi të punës të kategorisë së specialistëve dhe profesionale si pjesë e një prej klasave të parashikuara në nenin 14 dhe 15 të kësaj Rregullore, bëhet nëpërmjet analizës dhe vlerësimit të nivelit të faktorëve të klasifikimit dhe të kriteret e përgjithshme të kërkuara. 2. Analiza e faktorëve të klasifikimit bëhet për çdo faktor mbështetur në përshkrimin e vendit përkatës të punës. 3. Karakteristikat që paraqet pozita konkrete sipas secilit faktor, krahasohen me karakteristikat e faktorëve të klasifikimit të përcaktuar për çdo klasë në pajtim me Shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregulloreje. 4. Pozita vlerësohet e klasifikuar në atë klasë me karakteristikat sipas faktorëve të cilës ka më shumë ngjashmëri.

- **Nenit 24**, ku përcaktohet: *Vlerësimi për klasifikimin e pozitave të punës të kategorisë të specialistëve dhe kategorisë profesionale, bëhet nga Grupi i Vlerësimit, çdo herë që përgatitet një Rregullore e organizimit të brendshëm të institucionit.*

- **Nenit 25**, ku përcaktohet: *1. Grupi i vlerësimit për klasifikim themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit. 2. Grupi i vlerësimit për klasifikim përbëhet nga një përfaqësues i NJMBNJ-së, dhe nga nëpunës tjerë civilë me përvojë në institucionin përkatës.*

- **Nenit 26**, ku përcaktohet: *1. Grupi i Vlerësimit për Klasifikim analizon dhe vlerëson pozitat, harton propozimin për klasifikimin e pozitave dhe paraqet për veprime të mëtejshme tek drejtuesi më i lartë administrativ të institucionit. 2. Pas miratimit nga drejtuesi më i lartë i administrativ i institucionit, propozimi përfshihet në draftin e Rregullores së organizimit të institucionit.*

- **Nenit 27**, ku përcaktohet: *1. Klasa të cilës i përket secila pozitë konkrete e kategorisë së specialistëve dhe profesionale, përcaktohet dhe miratohet njëkohësisht me Rregulloren për Organizim të Brendshëm të Institucionit. 2. Miratimi përfundimtar i klasifikimit të vendeve të punës ndjek procedurën për propozimin dhe miratimin e Rregullores së Organizimit të Brendshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.*

Kolegji i Këshillit, referuar kuadrit ligjor të cekur si më lartë, Vendimit me Nr.08/226 të datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për miratimin e Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, vlerëson se organi përkatës i punësimit, gjegjësisht Njësia e për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Klinës, duhet të ndërmarr veprimet për klasifikimin e vendeve të punës për ankuesin, në pajtueshmëri me kriteret e parashikuar me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Vendimit me Nr. 08/226 të datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.488/2025

Atdhe Gashi

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Procesmbajtëse

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, L.D.;
- Organit të punësimit: Kryetarit të Komunës, dhe
Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.